



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KRYETARI

URDHËR

Nr. 193, datë 11/07/2018

Në mbështetje të pikës 5 dhe 6 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 1 dhe 2 të nenit 62 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë ndaj të cilëve Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendos masën disiplinore “shkarkim nga detyra”, nuk marrin pjesë në shqyrtimin dhe gjykimin e çështjeve gjyqësore, në Dhomë Këshillimi apo Seancë Gjyqësore, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Kolegji i Apelit ose marrjen formë të prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Çështjet gjyqësore me afate gjykimi të menjëhershëm për të cilat gjyqtari i shkarkuar nga detyra është caktuar relator, do të rihidhen me short mes gjyqtarëve të tjerë të të njëjtit Kolegj ose, në pamundësi, midis gjyqtarëve të Kolegjeve të tjera, ndërsa çështjet në të cilat është anëtar i trupit gjykues, do të gjykohen nga gjyqtarët e gatshëm.
3. Sektori IT të marrë masat e nevojshme teknike në sistemin ICMIC për mospërfshirjen e gjyqtarëve të shkarkuar nga detyra nga zhvillimi i shortit elektronik për çështjet gjyqësore të regjistruara pas datës së shpalljes së vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ndhmësit ligjorë të këtij gjyqtari të vazhdojnë ushtrimin e rregullt të detyrës, në përputhje me urdhrat e porositë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe Kryetarit të Kolegjit ku gjykonte gjyqtari pranë të cilit ushtronin detyrën dhe te trajtojnë dosjet gjyqësore sipas rradhës së regjistrimit si dhe normës mujore të përcaktuar.
5. Ngarkohet Kancelari, Sektori IT dhe Sektori i Regjistrimit për zbatimin e këtij Urdhri.
6. Ky urdhër tu komunikohet anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe ndihmësave ligjorë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

